



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Federata Org. Unit	M
Nr. i Protokollit Prot. No.	5169/23
Nr. i Shërbimit Pr. Shërbime	01
Data Datum	08.09.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Nr. 252  
Data: 31/08/2023

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7, 01 Mars 2019), nenin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85/2010), nxjerrë:

**V E N D I M**

**PËR SHPALLJEN NËN MBROJTJE TË LLOJIT VENDOR TË ZBUTUR - "GJELI KËNDIM GJATË I DUKAGJINIT"**

1. Lloji vendor i zbutur "Gjeli Këndim Gjatë i Dukagjinit" shpallet nën mbrojtje lloj vendor i zbutur.
2. Qëllimi i mbrojtjes, rregullat e mbarështimit, ruajtja e bazës gjenetike dhe parametrave fenotiporë, mënyra e ruajtjes dhe e shfrytëzimit të llojit të mbrojtur "Gjeli Këndim Gjatë i Dukagjinit" bëhet sipas Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.
3. Të drejtën për mbajtjen dhe përkujdesjen e llojit "Gjeli Këndim Gjatë i Dukagjinit" e ka secili person i cili i plotëson kushtet për mbarështim, mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenien e këtij lloji në pajtim me këtë Vendim dhe Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.
4. Lloji "Gjeli Këndim Gjatë i Dukagjinit" regjistrohet në Regjistrin për vlerat e Mbrojtura të Natyrës të cilin e mbanë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Liburn Alu

Ministër i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit  
Hapësinor dhe Infrastrukturës

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- DMMU;
- AMMK/IKMN-së;
- MBPZHR
- Asociacionit Kombëtar për Kultivimin e Kafshëve të Imta;
- Shoqatës për Kultivimin e Shpezëve "Gjeli i Egër i Kosovës" Pejë; dhe
- Arkivit të MMPHI-së